



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019), nenit 40 dhe nenit 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit të dorëzuar në postën elektronike ....., Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në vazhdimin e seancës së 46-të të mbajtur me datë 19 shkurt 2021 morri

### VENDIM

Procedura për lëndën nr.12-4276 nga viti 2019 e formuar pas denoncimit nr. 12-4276/1 me datë 13.09.2019, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nëpërmjet postës elektronike nga - ....., **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent në lëndën me numër 12-4276 nga viti 2019, për rastin zhvillohet procedurë pran organi tjetër kompetent e cila ende është në rrjedhë.

Lënda me numër 12-4276 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi të dorëzohet Vendimi i KSHPK me sqarimin

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

### SQARIM

Lënda me numër 12-4276 nga viti 2019 është formuar në bazë të denoncimit nr. 12-4276/1 me datë 13.09.2019, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, nëpërmjet postës elektronike nga parashtruesi - .....

Në denoncim flitet për akuza kundër operatorit për kryerje të shërbimeve mortore ..... SHPKNJ ..... - ....., për punë joligjore dhe kërkohet që mos t'i vazhdohet licenca për kryerje të veprimtarisë për sigurim të shërbimeve mortore. Në rastin konkret, bëhet fjalë për akuza për sjellje joligjore dhe joprofesionale nga ana e personit juridik të përmendur gjatë transportit të kofomave të personave të vdekur nga vendi i vdekjes deri në vendin ku ruhen – kapellë, gjegjësisht kanë veprur në kundërshtim me ligjin për varreza dhe shërbime mortore, sipas të cilës ky lloj i transportit mund të bëhet vetëm nga NP Varrezat e qytetit dhe personat e vdekur për të cilat ka bërë shërbime mortore, periudhë më të gjatë kohore në vend që t'i bartë në kapellë, i ka lënë në furgon në parking në rrethin e ndërmarrjes së tij dhe ditën tjetër i ka transportuar dhe i ka varrosur nëpër fshatrat, kurse familjarëve të të vdekurit, iu ka bërë pagesë edhe për transport deri në varrezat e qytetit, hyrje në varrezat e qytetit, ruajtje të kufomave të personave të vdekur në kapellë, kurse e tërë kjo në dëm të buxhetit të ndërmarrjes publike.

Gjatë rishikimit të rastit tëlëndës, KSHPK i merr parasyshë akuzat e parashtruesit dhe në drejtim të përcaktimit të gjendjes faktike, dorëzoi kërkesë deri në PThP ..... për të dhëna dhe informacione për rastin e lëndës. Me kërkesë të KSHPK është vepruar, janë dorëzuar të

dhënat e kërkuara dhe pas rishikimit të dokumentacionit të plotë me të cilën disponon për rastin e lëndës nga ana e KSHPK është caktuar gjendja faktike vijuese:

- Në lidhje me rastin e lëndës, kan vepruar nga ana e inspektoratit komunal të Komunës ....., e cila ka vepruar për këtë rast para një viti dhe gjatë kompetencave të veta kan vepruar tek personi juridik, në denoncimin e dorëzuar iu është dhënë Vendim për ndërprerje të punës, i cili vendim është vërtetuar nga ana e komisionit të shkallës së dytë.
- Në lidhje me këtë rast në media ka pasur një publikim me datë 26 maj 2017, në të cilën flitet se ----- policia ka dorëzuar kallëzim penal kundër D.SH. .... nga ....., pronar dhe menaxhues i ndërmartjes për shërbime mortore ..... nga ....., e cila ka qenë e autorizuar për kryerje të shërbimeve mortore, për punë të pakujdesshme në shërbim.
- Me datë 09.12.2020, me kërkesë të KSHPK është marrë përgjigje nga Prokuroria themelore publike ....., me të cilën informojnë se në këtë prokurori publike është vulosur lëndë Ko.nr. ..../..... kundër personit ..... nga ..... për veprë penale, veprim të pakujdesshëm në shërbim nenin 353-v paragrafi 4 në lidhje me paragrafin 1 dhe 2 nga Kodi penal, si dhe atë se në lëndën e përmendur janë të bashkuara edhe shkrimet për lëndën e saj Ro.nr. ..../.... Për lëndën procedura ende është në rrjedhë dhe ende nuk është marrë akt-akuzë nga prokuroria publike dhe i njëjti gjendet në punë tek prokurori i lëndës tek i cili lënga i është nda në përputhje me rendin për punë në këtë prokurori themelore publike.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të caktuar, KSHPK kostaton se në rastine lëndës veprohet nga ana e organi tjetër kompetent – Prokuroria themelore publike ....., pas formimit të lëndës në të cilën procedura ende është në rrjedhë dhe ende nuk është marrë akt-akuzë nga prokuroria nga ana e prokurorit publik tek i cili lënda është nda. Duke pasë parasyshë të konstatuarën, KSHPK vlerëson se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për rastin e lëndës, procedura për lëndën të ndërpritet kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Në bazë të tërë kësaj të shënuar më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

Dorëzuar deri tek: Arkiva dhe Parashtruesi  
Pas përfundimit të KSHPK  
Përpunoi: J. C., këshilltarë  
Miratoi: m-r Sh. S., anëtar i KSHPK

**KOMISIONI SHTETËROР ПЁР  
PARANDALIM ТЁ КОРРУПСИОНИТ  
Zëvendës-Kryetarë: Shemshi Sallai**